ETF Working together Learning for life
European Training Foundation

wiiw
The Vienna Institute for International Economic Studies

# AGENDA

| | |
|---|---|
| EMRI I NGJARJES | **Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë** |
| VENDI | **Webinar në internet, i organizuar në Zoom** |
| Data: | **27 maj 2021, ora 10:00 - 12:30** |
| REGJISTRIMI | **Linku në Zoom** |

## KONCEPTI

Vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga popullsia në rënie e shtyrë nga niveli i ulët i lindjeve, plakja e popullsisë dhe emigrimi i vazhdueshëm. Emigrimi nga rajoni ka qenë konstant që nga vitet 1990, duke evoluar nga migracioni i parregullt i fuqisë punëtore me shkathtësi të ulëta e të mesme deri te ribashkimi i rregullt familjar, studentë ndërkombëtarë dhe, së fundmi, migrim i fuqisë punëtore më shkathtësi të larta.

Në vitin 2020, Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF), së bashku me Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), iniciuan një studim rajonal të titulluar “Dinamikat e migrimit nga perspektiva e kapitalit njerëzor në Ballkanin Perëndimor”. Qëllimi i studimit ishte të hidhej dritë mbi marrëdhëniet trekëndëshe midis formimit të kapitalit njerëzor, tregjeve të punës dhe migrimit, dhe të përcaktojë si ndikon funksionimi aktual i sistemit arsimor dhe tregut të punës në migrimin në secilin vend.

Si rezultat i studimit, u hartua raporti për vendin “Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë” bazuar në një kornizë të përbashkët analitike të zhvilluar nga ETF dhe wiiw.

**Objektivi i webinarit** është të prezantohen dhe diskutohen gjetjet kryesore të studimit të vendit në një grup të vogël pjesëmarrësish nga institucionet përkatëse publike, hulumtuesit, shoqëria civile dhe donatorët në Kosovë. Temat e diskutimit do të përfshijnë përbërjen arsimore/të aftësive të emigrantëve kosovarë, arsyet dhe llojet e flukseve të fundit migratore, ndikimin e tregut të punës dhe strukturat arsimore mbi migracionin dhe politikat kryesore për të përmirësuar marrëdhënien trekëndëshe midis migrimit, arsimit dhe tregjeve të punës.

**Rezultati i webinarit** është kontrollimi dhe vërtetimi i gjetjeve kryesore të studimit për Kosovën. Informatat kthyese të pranuara nga pjesëmarrësit do të merren parasysh në finalizimin e raportit për vendin, i cili do të shpërndahet gjerësisht.

**Detajet e organizimit:** Kjo punëtori online do të mbahet në anglisht, me interpretim simultan në gjuhën shqipe. Pjesëmarrëseve të regjistruar do t’iu dërgohet në email një *link për tu kyçur në webinar në zoom*. Ju lutemi të lidheni në orën 9:45 në mënyrë që të testohen cilësimet dhe lidhja e audios dhe videos.

## Webinar: Si ndërveprojnë migrimi, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Kosovë
## 27 maj 2021 (e enjte), 10:00 - 12:30

# DRAFT AGJENDA

**Kryesuesi: Evelyn Viertel,** Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF)

| | |
|---|---|
| 09:45 – 10:00 | Organizatori hap webinarin dhe mundëson të testohet pjesa teknike (p.sh. video, zëri) |
| 10:00 – 10:15 | **Mirëseardhja dhe hyrja**<br>• **Znj. Manuela Prina,** ETF, Shefe e Njësisë për identifikimin dhe zhvillimin e shkathtësive<br>• Zyra e BE-së në Kosovë (TBC) |
| 10:15 – 10:25<br><br>10:25 – 11:15 | • **Prezantimi i kornizës analitike për analizimin e migracionit, kapitalit njerëzor dhe tregjeve të punës,** Michael Landesmann, wiiw, Koordinator i Projektit<br>• **Prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit për vendin mbi migracionin, kapitalin njerëzor dhe tregun e punës në Kosovë,** Prof. Asoc. Ardiana Gashi, Universiteti i Prishtinës<br>Pyetje dhe diskutim |
| 11:15 – 11:25 | Pauzë për kafe |
| 11:25 – 12:25 | **Moderator: Ummuhan Bardak,** ETF, Specialist i tregut të punës dhe migracionit<br>**Diskutim në panel mbi gjetjet kryesore dhe implikimet e politikave** (10 minuta për komente nga aktorët kryesorë)<br>▪ **Znj. Nora Latifi Jashari,** Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit GAP për studime të avancuara<br>▪ **Dr. Will Bartlett,** Studiues i lartë vizitues, LSEE (Kërkim mbi Evropën Jug-Lindore)<br>Pyetje dhe diskutim |
| 12:25 – 12:30 | **Konkluzione dhe hapat e ardhshëm**, Ummuhan Bardak, ETF |